



ABI Invest Sha

Raporti Vjetor

2021

ABI Invest Sha
ABI EIA
ABI FLEX EURO
ABI FLEX USD

Rreth ABI Invest Sha

ABI Invest sh.a është liçencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Mars 2020. Në Dhjetor 2020 dhe Qershor 2021, Autoriteti ka miratuar prospektet e fondeve të investimit nën administrimin e saj, respektivisht ABI EIA dhe ABI Flex EURO dhe USD.

ABI Invest sh.a ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Totali i aseteve nën administrim të ABI Invest sh.a në përfundim të 2021, ishte EUR rreth 4.25 milionë.



info@abinvest.al



+355 44 537390



Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27
Tiranë, Shqipëri
1001

ABI Invest Sha

Përmbajtja

TABELA PËRMBAJTJES	FAQET
Rreth ABI Invest Sha	01
Mesazh nga Këshilli Administrimit	04
Pritshmëritë për 2022	05
Tregjet Kombëtare dhe Ndërkombëtare	06
Misioni & Vlerat	08
Qeverisja Korporative	08
Transparenca	08
Kujdesi	08
Konflikti Interesit	08
Përgjegjësia Sociale	09
Trajnime/Edukimi Financiar	10
Fondet e Investimit	11
Fondi i Investimit ABI EIA	11
Fondi i Investimit ABI FLEX EURO	13
Fondi i Investimit ABI FLEX USD	13
Raporti i Menaxherit të Riskut	14



Mesazh nga Këshilli Administrimit

Të nderuar Investitorë!

Të gjithë së bashku kaluam një periudhë aspak të lehtë gjatë 2020 dhe nëpërmjet 2021 kuptuam se asgjë, sado e mbrapshtë apo e trazuar qoftë, nuk zgjat shumë gjatë.

Njerëzimi ka një dhunti të jashtëzakonshme, përshtatjen. Nëpërmjet kësaj dhurate, çdo ditë e më shumë, kuptojmë që e ardhmja do të jetë e mbarë dhe çdo vështirësi do të tejkalohet nëse e përballojmë të gjithë bashkë.

Periudhave të tilla, mund t'iu shkëpusim eksperiencën e fituar si vlerë të madhe. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se e njëjta vështirësi nuk ka asnjë mënyrë tashmë të n'a kapë përsëri të papërgatitur.

ABI Invest pati përpara një sfidë shumë të madhe, atë të përgatitjes dhe fillimit të aktivitetit gjatë dhe pas një periudhe shumë të vështirë. Megjithatë në Shkurt 2021 u lançua Fondi i Investimeve në LEK "ABI EIA", asetet e të cilit u rritën me 38% deri në 31.12.2021 dhe përfitueshmëria arriti brenda më pak se 1 viti kalendarik në 2.10%. Në Tetor 2021 u lançuan dy fonde të tjera, këtë herë në monedhë të huaj, "ABI Flex EURO" dhe "ABI Flex USD". Lançimi i fondit në USD shënoi edhe një risi në tregun e fondeve të Investimit në Shqipëri, duke e bërë ABI Invest të parën shoqëri administruese që menaxhon një fond i cili emeton dhe shlyen kuota në monedhën USD.

Në këtë mënyrë, ABI Invest mbulon në 360 gradë nevojat e investitorëve duke ofruar produkte në monedhat që gjejnë më shumë përdorim në Shqipëri, duke u dhënë mundësi klientëve të mos marrin risk nga kursi i këmbimit gjatë investimit.

E udhëhequr nga transparenca, përgjegjësia dhe integriteti si dhe nga besimi Juaj, ABI Invest ka besimin dhe bindjen se do të çojë përpara historinë e suksesit të aksionerit të saj, Banka Amerikane e Investimeve Sha.

Me respekt,
Armand Muharremi
Kryetar i Këshillit të Administrimit

Pritshmëritë për 2022

ABI Invest synon të mbajë një qasje të moderuar ndaj riskut, duke u ekspozuar më kujdes, duke u diversifikuar dhe duke u përshtatur me zhvillimet më të fundit të tregjeve, duke mbajtur në fokus interesin më të mirë të investitorit, si dhe duke zbatuar me rigorozitet angazhimet e marra në strategjitë e shpallur për fondet nën administrim.

Tregjet Kombëtare dhe Ndërkombëtare



Shqipëria

Normat e interesit në Shqipëri do të jenë në fokus të zhvillimeve të tregut lokal. Megjithatë, duke marrë parasysh suksesin e emetimit të EUROBOND në Nëntor 2021, një raport optimal dhe një menaxhim i mirë i qeverisë të nivelit të borxhit në LEK përgjatë 2022, mund të lehtësojë presionin tek fondet e investimit duke absorbuar dhe shtrirë në kohë skenarin rritës së normave të interesit.



Eurozona

Situata e vështirë mes Rusi – Ukrainë, ka shkaktuar pasiguri dhe prishje të balancave tregtare, ekonomike të vendosura tashmë prej vitesh. Nivele të larta inflacioni, të cilat do të sjellin presione zhvillimesh të reja në rritje të normave të interesit, do ta vështirësojnë ri-vendosjen e ekuilibrave sidomos në tregjet e kapitalit të cilat kanë ndjeshmëri të lartë nga faktorët e mësipërm.



Shetet e Bashkuara të Amerikës

Ndikimi i konfliktit Rusi – Ukrainë nuk duket i drejtpërdrejtë në tregjet e saj të kapitalit. Megjithatë, parashikimet për rritje të normës bazë të interesit janë të prekshme. Brenda 2022, norma do të rritet në disa transhe të cilat do të lajmërohen pas mbledhjeve respektive të FED (Federal Open Market Committee) që zhvillohen gati çdo muaj. Tregu i titujve të borxhit është ai i cili do të goditet më shumë nga këto rritje.



ABI Invest udhëhiqet nëpërmjet

Misionit:

Nëpërmjet produkteve të thjeshta, të mirëdiversifikuara dhe transparente, të sjellim investimet më pranë çdo klienti.

Ky mision bëhet i arritshëm duke:

- Respektuar nevojat dhe pritshmëritë e çdo investitori;
- Qendruar afër investitorit duke përcjellë informacionin në mënyrë të prekshme dhe transparente
- Menaxhuar në mënyrë profesionale asetet nën administrim

Vlerave:

- Intergriteti në vlerësim
- Etika në bashkepunim
- Disiplina në analizë

Qeverisja Korporative

ABI Invest sh.a është shoqëri aksionare, me seli në Rruga e Kavajës 27/1, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Banka Amerikane e Investimeve Sha.

Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratori

Këshilli i Administrimit:

Këshilli i Administrimit mbikëqyr zbatimin e politikave dhe strategjive të shoqërisë.

Këshilli përbëhet nga:

Kryetar. **Z. Armand Muharremi**, CFO – Banka Amerikane e Investimeve Sha

Nën kryetare Zj. **Teuta Lloshi**, Drejtore e Thesarit, Banka Amerikane e Investimeve Sha

Anëtare Zj. **Brikena Hoxha**, Drejtore e Departamentit Ligjor, Banka Amerikane e Investimeve Sha

Anëtar **Z. Redi Hakani**, Administrator

Z. Redi Hakani

Administrator i Përgjithshëm

Transparenca

ABI Invest e trajton Transparencën ndaj Investitorit, si një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të saj. Shoqëria publikon raportet periodike të saj dhe të fondeve nën administrim, çdo përditësim në dokumentacion, informacion për ecurinë ditore të NAV, çmimit dhe numrit të kuotave, investment outlook etj. Çdo investitor mund të kontrollojë nëpërmjet aksesit nga website www.abinvest.al llogarinë e tij ku mund të marrë informacion mbi ecurinë e investimit dhe të portofolit në tërësi.

Kujdesi

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë në të njëjtin këndvështrim të atij të administrimit të financave dhe investimeve personale të vetë personelit kyç i cili ka në ngarkim këtë funksion. Përpjekje maksimale e transparente kryhen për të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve me aplikimin e masave prudenciale të riskut pa prapaskena arbitrazhi e spekulimi, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

Konflikti i Interesit

Shoqëria administruese, vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në çdo lloj sipërmarrjeje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të.

Përgjegjësia Sociale

Të qenit pjesë e grupit ABI i cili ka në fokus të tij mbështetjen e aktiviteteve me karakter social, ka bërë që ABI Invest të jetë pjesë e ketyre nismave që në nisje të aktivitetit të saj. Konkretisht gjatë 2021, ABI Invest ka mbështetur aktivitete sociale të ndryshme si:

NISMA E FONDACIONIT ÇELESI IM “KËPUCËT E KRISHTLINDJES”



NISMA E FONDACIONIT ÇELESI IM “KËPUCËT E KRISHTLINDJES”

FOOD BANK ALBANIA “SOLIDARITET KUNDER URISË”

Në prag të festave të fundvitit, Banka Amerikane e Investimeve dhe ABI Invest i janë bashkuar nismës së ndërmarrë nga Fondacioni Çelësi Im, “Këpucët e Krishtlindjes”. Në kuadër të këtij projekti u dhuruan 100 palë këpucë për fëmijë të familjeve në nevojë, të zonave të thella të qyteteve Shkodër, Korçë dhe Lushnjë.

Stafi i ABI Bank dhe ABI Invest në prag të festave të fundvitit, ndërmori nismën vullnetare të dhurimit të produkteve ushqimore, në bashkëpunim me FOOD BANK ALBANIA, në mbështetje të 56 familjeve shqiptare në nevojë.



SOLIDARITETI PËR USHQIM

*Mbi 300 000 Shqiptarë rrezikohen nga uria çdo ditë.

MISIONI YNË

T'u sigurojmë tepërcat ushqimore Shqiptarëve që kanë deficiet ushqimor, duke vepruar në harmoni me një rrjet partnerësh vendas e ndërkombëtarë.

Trajnime/ Edukimi Financiar

Gjatë gjithë 2021, ABI Invest sh.a. ka mbajtur një nivel të lartë të takimeve me karakter edukues dhe informues me personelin shitës. Gjithashtu takime informuese dhe sqaruese organizohen në çdo rast edhe me investitorë ekzistues apo potenciale.



ABI Invest Sha

Fondet e Investimit

Gjatë 2021, ekonomia pati rimëkëmbje dhe normat e interesit treguan stabilitet krahasuar me vitin e kaluar. Ky ndryshim ndikoi që ABI EIA, fondi në lek i ABI Invest, të kishte një performancë të kënaqshme. Më 18 Nëntor 2021, ABI Invest lançoi dy fonde të reja të denominuara në valutën EUR dhe USD. ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD kanë një portofol investimesh të diversifikuar në klasa të ndryshme asetesh si: aksione, obligacione dhe metale të çmuara.

Të dhënat per fondet e investimeve nën administrimin e ABI Invest

	ABI EIA	ABI FLEX EURO	ABI FLEX USD
Çmimi i Kuotës	1,020.9925	100.1517	100.0000
NAV	374,182,787.98	691,281.61	514,000.00

Tarifat e fondeve nën administrimin e ABI Invest

	ABI EIA	ABI FLEX EURO	ABI FLEX USD
Tarifa e Administrimit në bazë vjetore	1.00%	2.00%	2.00%

1. Fondi i Investimit ABI EIA

Fondi ABI EIA është i denominuar në monedhën Lekë. Objektivi i fondit është të maksimizojë kthimin afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi investon në letra me vlerë të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi i Investimit nuk aplikon tarifa hyrjeje dhe daljeje.

Duke marrë parasysh kohën e nevojshme që duhet për zbatueshmërinë sa më të përshtatshme të politikave të investimit në mënyrë që të synohet (por jo të garantohet) maksimizim i kthimit, rekomandohet që periudha minimale e qëndrimit në fond të jetë 2 vjet.

Fondi nisi aktivitetin në Mars të vitit 2021 dhe më 31 Dhjetor 2021, vlera neto e aseteve përgjatë kësaj periudhe është rritur me 38% dhe fondi ka realizuar një kthim neto prej 2.10%.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar në tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga Republika e Shqipërisë.


Më 31 Dhjetor 2021, shpërndarja e aseteve në portofolin e investimeve është si më poshtë:

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione Thesari	81.38
Bono Thesari	5.31
Depozita	12.87
Cash	0.59

Investimet e kryera në fond janë kryesisht në obligacione afatshkurtër dhe afatgjatë ku gjithashtu ka dhe bono thesari deri në 12 muaj. Likuiditeti i tepërt mbahet në depozita afatshkurter në banka lokale. Kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit më 31 Dhjetor 2021 është 2.36.

1.1 Performanca

Fondi ka nisur aktivitetin në Mars të vitit 2021 dhe nga fillimi i aktivitetit deri më 31 Dhjetor 2021, fondi ka realizuar një kthim neto prej 2.10%.



Çmimi i kuotës ka ndjekur një trend rritës përgjate muajve të vitit 2021. Stabilizimi i normave pas pandemisë solli rritje të vlerës së aseteve në portofolin e investimeve. Por politika jonë e investimit shfaq qartë një qasje defensive, duke u pozicionuar në obligacione afatshkurtra. Kjo na pozicionon më mirë për një ambient ekonomik inflacionues dhe normash në rritje. Te cilat janë në pritshmëri për vitin e ardhshëm. Në këtë mënyrë ne minimizojmë riskun e rënies së çmimit të kuotës.

1.2 Strategjia e Investimit për 2022

Për të përmbushur objektivat e investimit dhe për të përmirësuar rritjen reale afatgjatë të aseteve të fondit, strategjia do të jetë kryesisht e përqëndruar në investime afatmesme dhe afatgjata duke pasur në konsideratë të përmbahet niveli i deklaruar i duration të portofolit.

Top 10 Investimet kryesore më 31 Dhjetor 2021	% e NAV
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet	9.59
Obligacion Thesari Referencë 2 vjet	9.47
Obligacion Thesari Referencë 3 vjet	9.2
Depozitë afatshkurtër	8.82
Obligacion Thesari Referencë 7 vjet	8.71
Obligacion Thesari Referencë 2 vjet	7.45
Obligacion Thesari Referencë 10 vjet	6.43
Obligacion Thesari Referencë 7 vjet	5.69
Obligacion Thesari Referencë 5 vjet	5.62
Obligacion Thesari Referencë 10 vjet	5.31

2. Fondi i Investimit ABI FLEX EURO

Fondi ABI FLEX EURO është i denominuar në monedhën Euro. Objektivi i investimit të fondit është rritja e kapitalit në periudhë afatgjatë.

Fondi synon të investojë në instrumente financiare si: Tituj Borxhi, Aksione, Fonde të tregtueshmë, minerale të çmuara dhe ekuivalentë cash-i.

Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 18 Nëntor 2021. Periudha e ofertës fillestare filloi më 18 Tetor 2021 dhe përfundoi më 17 Nëntor 2021.

Më 31 Dhjetor 202, vlera neto e aseteve të fondit është € 691,281.61.

2.1 Politika e Investimit

Fondi ABI FLEX EURO është një fond i cili ka ekspozim ndaj një shumëllojshmerie aktivesh. Fondi ka si synim rritjen e moderuar të kapitalit dhe synon të investojë në tregun e obligacioneve direkt duke investuar në llojet e obligacioneve të përcaktuara në politikën e investimit apo indirekt duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto instrumenta.

Fondi synon të investojë pjesërisht edhe në tregun e aksioneve direkt nëpërmjet investimit në aksione të shoqërive tregtare apo indirekt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive.

Për arsye diversifikimi një pjesë e vogël e aktiveve të fondit mund të shpërndahej gjithashtu edhe në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera, duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto tregje.

Fondi do të investojë gjithashtu në instrumenta të tregut të parasë, dhe në depozita bankare me qëllim menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit.

3. Fondi i Investimit ABI FLEX USD

Fondi ABI FLEX USD është i denominuar në monedhën Usd. Objektivi i investimit të fondit është rritja e kapitalit në periudhë afatgjatë.

Fondi investon synon të investojë në instrumente financiare si: Tituj Borxhi, Aksione, Fonde të tregtueshmë, minerale të çmuara dhe ekuivalentë cash-i.

Fondi ka filluar veprimtarinë e tij më 18 Nëntor 2021. Periudha e ofertës fillestare filloi më 18 Tetor 2021 dhe përfundoi më 17 Nëntor 2021.

Më 31 Dhjetor 202, vlera neto e aseteve të fondit është \$ 514,000.00.

3.1 Politika e Investimit

Fondi ABI FLEX USD është një fond i cili ka ekspozim ndaj një shumëllojshmerie aktivesh. Fondi ka si synim rritjen e moderuar të kapitalit dhe synon të investojë në tregun e obligacioneve direkt duke investuar në llojet e obligacioneve të përcaktuara në politikën e investimit apo indirekt duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto instrumenta.

Fondi synon të investojë pjesërisht edhe në tregun e aksioneve direkt nëpërmjet investimit në aksione të shoqërive tregtare apo indirekt nëpërmjet investimit në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive.

Për arsye diversifikimi një pjesë e vogël e aktiveve të fondit mund të shpërndahej gjithashtu edhe në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo të tjera, duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këto tregje.

Fondi do të investojë gjithashtu në instrumenta të tregut të parasë, dhe në depozita bankare me qëllim menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit.

4. Strategjia e Investimit gjatë 2022 për ABI FLEX EURO & ABI FLEX USD

Rikuperimi i ekonomisë botërore solli rritje të performancës së aseteve përgjatë vitit 2021. Përgjatë rimëkëmbjes, versioni i ri i COVID-19 solli volatilitet të shtuar në momente të ndryshme. Politika monetare për të mbrojtur ekonominë u ndoqën nga Shtetet e Bashkuara si dhe nga Bashkimi Europian, duke projektuar parashikime për inflacion të lartë gjatë 2022, në dritë gjithashtu edhe të situatës dhe risqeve që solli konflikti Rusi-Ukrainë. Për këtë arsye ne do të përqijemi të ndjekim një qasje të kujdesshme dhe difensive në një ambient inflacionist ku gjithashtu normat pritet të rriten përgjatë gjithë vitit. Për fondet e denominuara në monedhë të huaj, do të synohet një shpërndarje më e lartë në tregun e aksioneve duke u rezervuar më shumë nga obligacionet. Me gjithë vështirësitë që 2022 mund të sjellë, do të jemi vigjilentë për oportunitetet që mund të krijohen nga rënie të mundshme të tregut.

5. Raporti i Menaxherit të Riskut

Administrimi i Riskut kryhet në mënyrë të pavarur dhe monitoron, mat dhe raporton respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Gjatë 2021, të gjitha limitet ligjore si dhe ato të deklaruara në prospektet e fondeve janë respektuar.

Fondi ABI EIA ka treguar stabilitet gjatë 2021, pasi dhe normat e interesit në tregun vendas nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha. Fondi ka kaluar me sukses të gjitha testet e kryera nga menaxheri i riskut.

Fondet ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD nisën aktivitetin më 18 Nëntor 2022 dhe është akoma shumë herët për të matur volatilitetin e tij. Por bazuar në treguesit e tyre sintetik dhe të përfitueshmërisë, të dy fondet vlerësohen me nivelin 5.

Fondi i Investimit	Kohëzgjata e modifikuar	Volatiliteti	Treguesi sintetik i Riskut
ABI EIA	2.36	0.46%	Niveli 3
ABI FLEX EURO	2.62	0.98%	Niveli 5
ABI FLEX USD	N/A	N/A	Niveli 5

Indikatorët janë për datën 31 Dhjetor 2021 dhe tregojnë të dhënat për periudhën nga nisja e aktivitetit të fondit deri më 31 Dhjetor 2021.

ABI Invest Sha Raporti Vjetor 2021



info@abinvest.al



+355 44 537390



Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27,
Tiranë, Shqipëri
1001